

SISTEMIMI NË SHKOLLË PASOJAT E KONFLIKTIT NË FAMILJE PRINDËRIT U NDIHMOJNË FËMIJËVE TË RUHEN, TË JENË TË LUMTUR DHE TË MËSOJNË



HYRJE

Personalitetet dhe ndjeshmëritë tona, bagazhi që e bartim prej fëmijërisë dhe përvojat e shkuara mund të na bëjnë të lëndueshëm dhe të pasigurt në marrëdhënie, më pak të aftë për të dhënë apo për të marrë dashuri ose për t'i përballuar konfliktet.

Ajo çka ndodh aktualisht në jetët tona ndikon edhe në mënyrën se si ndërveprojmë me njëri-tjetrin dhe se si reagojmë ndaj konflikteve. Nëse, për shembull, hasim në vështirësi financiare ose luftojmë me varfërinë apo me streset e punës, ose kemi probleme me fëmijët, është pothuajse e sigurt që do të kemi më shumë konflikte në shtëpi dhe do të jemi më pak të aftë për t'i zgjidhur mosmarrëveshjet tona.

LIDHJET NDËRMJET PARTNERËVE

Ashtu si dallojmë të gjithë ne nga njëri-tjetri, ashtu dallojnë edhe mënyrat e funksionimit të lidhjeve. Disa njerëz ndihen mirë në një lidhje të stuhishme; disa të tjerë janë në gjendje që t'i diskutojnë e t'i qartësojnë gjërat me qetësi; e ka edhe të tillë që vendosin të bëjnë jetë të qetë dhe që pajtohen me dallimet. Sido që të jetë, konfliktet janë gjithmonë pjesë e lidhjeve.

Shumë dallime e mospajtime – në fakt, shumica – janë të pazgjidhshme, kështu që pranimi i tyre ose kompromisi ndonjëherë paraqesin mënyrën e vetme për të shkuar përpara.

Çiftet synojnë që ta ruajnë vetëdijen e lidhjes, t'i ofrojnë njëri-tjetrit mbështetje dhe dashuri, ta rregullojnë ndarjen e pushtetit dhe të kalojnë sa më shumë kohë të mirë me njëri-tjetrin, në mënyrë që kjo t'i baraspeshojë ndikimet negative të konflikteve.

PO FËMIJËT?

Fërkimet e krijuara mes prindërve apo kujdestarëve të fëmijëve mund të jenë simptomë e një lidhjeje me grindje dhe mund të kenë pasoja tepër të këqija mbi fëmijët.

Fëmijët janë posaçërisht në rrezik kur:

- Konflikti është i vazhdueshëm dhe i thellë
- Grindjet janë plot me agresione fizike dhe gojore
- Prindërit e trajtojnë njëri-tjetrin me përbuzje të qeta ose me "marrëveshje të heshtura"
- Njëri prind tërhiqet gjatë argumentimit apo largohet
- Mosmarrëveshjet kanë të bëjnë me fëmijët

QËNDRUESHMËRIA E FËMIJËVE

Shumica e fëmijëve janë të qëndrueshëm dhe e kuptojnë që prindërit e tyre i duan edhe kur prindërit nuk shkojnë tepër mirë me njëri-tjetrin.

- Kur prindërit i duan fëmijët dhe përkujdesen për ta, shumica e fëmijëve u bëjnë ballë vështirësive dhe përparojnë
- Të gjithë kanë konflikte në lidhjet e veta, mosmarrëveshjet janë të pashmangshme

- Edhe anëtarët e tjerë të familjes mund të ndihmojnë dhe ta rrisin mirëkuptimin e fëmijëve
- Mënyra se si zgjidhet konflikti është çelësi i gjithë kësaj pune

KËSHILLAT KRYESORE PËR PRINDËRIT

Hulumtimet ofrojnë këshilla të ndryshme për trajtimin e konflikteve në shtëpi. Jo të gjitha sugjerimet do të jenë të dobishme për ju, pasi në fund të fundit ju e njihni më së miri familjen tuaj.

- Mos u përpiqni që ta fshihni konfliktin. Fëmijët janë të ndjeshëm ndaj atmosferës së tendosur dhe e kuptojnë fare mirë kur gjërat nuk shkojnë siç duhet.
- Mos debatoni në sy të fëmijëve – ata do të mendojnë se faji është i tyre.
- Nëse debatoni në sy të fëmijëve, atëherë lëroni që t'ju shohin se si pajtoheni, dhe nëse është e mundur, të shohin edhe si e zgjidhni problemin. Humori, kërkimi i faljes dhe mirëkuptimi që mund të pasojnë, u ofrojnë fëmijëve një model fantastik që mund ta përdorin për vete në të ardhmen.
- Nëse fëmija nuk e sheh zgjidhjen e problemit, atëherë bëjani me dije se i keni zgjidhur mosmarrëveshjet me partnerin tuaj dhe se çdo gjë është në rregull.
- Mos u përpiqni t'i shtyni fëmijët që të mbajnë anën e dikujt dhe mos u kushtoni atyreve vëmendje të tepruar vetëm pse gjërat me partnerin tuaj nuk shkojnë si duhet. Më mirë është që t'iu kushtoni kohë për t'ua dëgjuar mendimin dhe t'iu ndihmoni që t'i shprehin ndjenjat e veta.
- Nëse është e mundur, mbani një qëndrim të përbashkët me partnerin tuaj sa i përket disiplinës.
- Nëse ju ose partneri juaj kaloni nëpër kohë të vështira, ndiqni me vëmendje çfarëdolloj ndryshimi në sjelljen e fëmijës tuaj. A janë bërë më të tërhequr? A kanë filluar të sillen keq? Mos iu vjen vështirë që të sistemohen në shkollë?

Për informata dhe këshilla të mëtejme:

Nëse konflikti që keni del të jetë problem serioz, është mirë të mendoni të kërkoni ndihmë nga jashtë, sidomos nëse mendoni se fëmijët tuaj po ndikohen nga ky konflikt. Ka mundësi që ndonjëra prej organizatave të mëposhtme mund t'ju ndihmojë.

ParentlinePlus – 0808 800 2222 (telefon kujdestar për ndihmë)

Relate – 0845 130 4010 (telefon kujdestar për ndihmë urgjente)

Marriage Care – 0207 371 1341

National Family Mediation – 0117 904 2825 (telefon kujdestar për ndihmë)

Families Need Fathers – 0870 7607 496 (telefon kujdestar për ndihmë)

Fathers Direct – 00845 634 1328

Pinkparents UK – 08701 273 274 (telefon kujdestar për ndihmë)

FLLAG (familjet dhe miqtë e lezbikeve dhe homoseksualëve) – 0145 486 2418 (telefon kujdestar për ndihmë)

National Domestic Violence Helpline – 0808 2000 247 (telefon kujdestar për ndihmë)

NSPCC – 0808 800 5000

Home-Start – 0800 068 6368 (telefon kujdestar për informim)

Ju lutemi shënojinë në vazhdim njoftimet lokale dhe mundësitë e kontaktimit

Të gjitha të drejtat e rezervuara © Crown, gusht 2006.